



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 352/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së banerit në rrugët publike, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega Kamenicë kështu që subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i, më datë 28.10.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik LVV dega në Kamenicë, në të cilën theksohet se me datën 26 tetor 2013, në lagjen Malësia në Kamenicë anëtarë të AKR-së kanë vendosur banerin e kandidatit të saj në urë veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotot nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, për ankesën në fjalë duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik AKR për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013, ora 16:00.

PZAP-i sipas afatit të paraparë pra me datën 29.10.2013 pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AKR në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza lidhur me vendosjen e banerit mbi urë dhe se dega e AKR-së nuk e ka vendosur atë baner mbi urë ashtu siç pretendohet në ankesë dhe se me të njoftuar për rastin në fjalë anëtarët e AKR-së kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë fotografimin e vendit ku pretendohet se ka qenë i vendosur baneri dhe se me atë rast nuk është vërtetuar se ka pasur baner mbi urë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se si baneri i kandidatit të subjektit politik AKR-së në komunën e Kamenicës ka qenë i vendosur në urë konkretisht mbi rrugët publike, e për të

cilat veprime subjekti politik AKR konsiderohet përgjegjës sipas nenit 33 pika b) të LZP-së dhe nenin 4.1 paragrafi b) i Rregullës Zgjedhore.

Prandaj PZAP-i për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj PZAP-i, lidhur me rastin në fjalë mori parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese PZAP-i mori se subjekti politik AKR shkelje të natyrës së tillë ka kryer edhe më parë dhe konsiderohet si recidivist. Si rrethanë tjetër rënduese mori atë se subjekti politik AKR edhe më parë ka marr pjesë në zgjedhje dhe në këto raste konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Prandaj vendosja e banerit të kandidatit të AKR-së në rrugët publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese në këtë rast PZAP-i, mori parasysh faktin se AKR në pajtim me nenin 32.6 të LZP-së, ka ndërmarr veprime konkrete duke e larguar menjëherë banerin e kandidatit të saj nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Prandaj PZAP-i duke i marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik AKR është përgjegjës për veprimet e tilla dhe se mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 118.1 lidhur me nenin 120. 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 352/2013 më datën 31.10.2013



#### ***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoja e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*